



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2899 prot.

Himarë, më 07.04 2025

VENDIM

Nr. 12 , Datë 02.04 2025

**“PËR DHËNIEN E MIRATIMIT NË PARIM PËR FILLIMIN E BASHKËPUNIMIT
ME SHOQËRINË “EGEU STONE”SH.P.K”**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin Nr.44/2025 “Kodi i procedurave administrative”, në nenin 22, nenin 23, të ligjit Nr.10 304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë: Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 02.04.2025 , pasi u njohë me shprehjen e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Vlorë, më datë 20.03.2025 dhe me nr.298/2 prot , në lidhje me aktin nr.10.datë 03.03.2025 , i cili shprehet se: për mungesë së votave të nevojshme e konsideron aktin si të pamiratur, akt nul. Këshilli ra dakort të rihidhet në votim dhe u miratua me (14) katërmëdhjetë vota pro , (6) kundër , (0) abstenim dhe si më poshtë vijon,

VENDOSI:

- 1.Dhënien e miratimit në parim për fillimin e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë dhe Shoqërisë “EGEU STONE”sh.p.k.
2. Dhënien e miratimit për Kryetarin e Bashkisë Himarë z. Vangjel Tavo, të përfaqësojë Bashkinë Himarë, në lidhjen e marrëveshjeve paraprake dhe përfundimtare të bashkëpunimit me Shoqërinë “EGEU STONE”sh.p.k., në fushën e nxjerrjes dhe shfrytëzimit të mineralit në interes të Bashkisë Himarë, sipas kushteve të lejes dhe kushteve të përcaktuara në këto marrëveshje.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar ne Ligjin nr. 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 55 pika 6.

KRYETARI
Dhimitër Kapaj

